



BULETINI M U J O R I

Gusht 2026



► Hapet Shërbimi i Trombektomisë në QSUT, ministrja Sala: Një ekosistem profesionist që i përgjigjet në kohë qytetarit

Trombektomia është tashmë një shërbim i disponueshëm për qytetarët në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, falë investimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, duke shënuar një hap të rëndësishëm në zgjerimin dhe modernizimin e shërbimeve të neuroradiologjisë intervenuese në vend. Instalimi i Angiografit Biplanar dhe krijimi i Kabinetit të Radiologjisë Intervencionuese mundësojnë diagnostikimin dhe trajtimin endovaskular të insultit ishemic akut përmes trombektomisë mekanike, si dhe trajtimin e patologjive të tjera vaskulare e cerebrovaskulare, përfshirë aneurizmat, përmes procedurave të avancuara si angiografia digjitale me substraksion (DSA). Ajo theksoi se investimi nuk përfshin vetëm teknologjinë, por edhe ngritjen dhe trajnimin e një ekipi të specializuar mjekësor, përfshirë neuroradiologët intervenues, infermierët dhe teknikët, për garantimin e cilësisë së shërbimit.



► Onkologjia shkon më pranë pacientit, rikualifikohet Njësia e re e Kimioterapisë në Korçë dhe Vlorë

Shërbimi onkologjik po afrohet gjithnjë e më shumë me pacientët. Në Spitalin Rajonal të Korçës dhe në Spitalin Rajonal të Vlorës është rikualifikuar njësia e kimioterapisë ditore, e rikonstruktuar dhe e pajisur sipas standardeve bashkëkohore për trajtimin e pacientëve me sëmundje tumorale. Gjatë vizitës në njësinë e re, Ministrija e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Prof. Evis Sala, theksoi se decentralizimi i shërbimeve onkologjike është një nga drejtimet kryesore të transformimit të kujdesit ndaj pacientëve me kancer dhe se po vijon puna për rikualifikimin e punkteve të tjera rajonale.



► Garancia Evropiane për Fëmijët, Ministria Sala: Plani i Veprimit 2026–2030 do të mbështesë rreth 100 mijë fëmijë në nevojë

Rreth 100 mijë fëmijë që përballen me përjashtim social ose me vulnerabilitete komplekse do të përfitojnë nga ndërhyrjet e parashikuara në Planin e Veprimit për Garancinë Evropiane për Fëmijët 2026–2030. Plani parashikon masa të koordinuara në fushën e mbrojtjes sociale, shëndetësisë dhe arsimit, me synimin për të garantuar akses më të mirë në shërbime cilësore dhe mundësi të barabarta për zhvillim. Në takimin me aktorët kombëtarë dhe ndërkombëtarë të përfshirë në hartimin dhe zbatimin e Planit, ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Prof. Evis Sala, theksoi se dokumenti përfaqëson një angazhim konkret për të mbështetur fëmijët dhe familjet që kanë më shumë nevojë.



► Nis thirrja e aplikimeve për kredi të lehtësuar për kategoritë “Mjekë” dhe “Infermierë”

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka hapur thirrjen për aplikime për përfitimin e kredisë së lehtësuar për strehim, për kategoritë e mjekëve dhe infermierëve. Kjo mundësi synon të mbështesë profesionistët e shëndetësisë në sigurimin e një banese, përmes një skeme financimi me kushte të lehtësuara. Mjekët dhe infermierët e interesuar mund të aplikojnë online ne portalin e-Albania duke ndjekur kriteret dhe procedurat e përcaktuara në thirrjen për aplikime.



HAPET THIRRJA PËR KREDI ME 0% INTERES

Afati fillon më date 27.8.2026

Perfundon me datë 25.9.2026



► Konsolidohet operatori publik i shërbimeve mbështetëse shëndetësore, ministrja Sala: Cilësi e siguri për çdo pacient

Shqipëria po konsolidon një model të ri publik për menaxhimin e shërbimeve mbështetëse të sistemit shëndetësor. Pas marrjes në administrim të shërbimit të integruar të sterilizimit, Operatori i Shërbimeve të Integruara Shëndetësore (OSHISH sh.a.) do të administrojë edhe dy shërbime kombëtare me rëndësi strategjike, Programin Kombëtar të Kontrollit Mjekësor Bazë (Check-Up) dhe shërbimin e dializës, duke u shndërruar në një operator publik të specializuar që garanton standarde të larta të cilësisë, sigurisë, efikasitetit dhe vazhdimësisë së shërbimeve. Në kuadër të këtij transformimi, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Prof. Evis Sala, inspektoi ambientet logjistike të OSHISH sh.a., ku po zbatohet modeli i ri i ofrimit të shërbimit të sterilizimit të instrumenteve kirurgjikale, furnizimit me sete kirurgjikale sterile dhe materiale mjekësore sterile njëpërdorimëshe dhe theksoi se zgjerimi i rolit të OSHISH përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të kapaciteteve të qëndrueshme publike për administrimin e shërbimeve shëndetësore mbështetëse.



► Ministria Sala: Më shumë kujdes për të moshuarit, për herë të parë ngrihet Shërbimi i Geriatriisë

Gjatë vizitës në Qendrën Komunitare Ditore “Epoka e Artë” në Korçë, ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala, njoftoi nisjen e punës për ngritjen, për herë të parë, të shërbimit të Geriatriisë në vend.

Shërbimi i ri do të ofrojë kujdes të specializuar dhe të integruar për të moshuarit, duke iu përgjigjur më mirë nevojave të tyre shëndetësore dhe sociale, si dhe duke mundësuar një qasje më të koordinuar dhe të vazhdueshme në kujdesin ndaj kësaj grupmoshe në të gjithë vendin.



► Nënshkruhet Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet MSHMS dhe SOS Fshatrat e Fëmijëve në Shqipëri

Është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe SOS Fshatrat e Fëmijëve në Shqipëri, duke forcuar bashkëpunimin për zbatimin e politikave dhe strategjive kombëtare në mbështetje të procesit të deinstitutionalizimit të fëmijëve. Ky partneritet nis me një angazhim konkret për zhvillimin e fushatave të komunikimit që promovojnë kujdesin alternativ në familje si dhe rritjen e ndërgjegjësimit të profesionistëve, institucioneve dhe komunitetit mbi rëndësinë e një mjedisi familjar të sigurt dhe mbështetës për çdo fëmijë.





BULETINI M U J O R I

Gusht 2026